



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR**

**RREGULLORE**

**Nr. 4, datë 15.09.2016**

**Rregullorja për regjistrimin dhe mbajtjen e regjistrit të anëtarëve dhe të licencave**

1. Rregullorja për regjistrimin e KM dhe kandidatëve për KM anëtarë të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar si dhe mbajtja e regjistrit të anëtarëve hartohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar“ i ndryshuar.
2. Në rregullore përfshihen dispozitat për procesin e licencimit të Kontabilistëve të Miratuar anëtarë të IKM në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar; Rregullores Nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe Mbikëqyrjes së Procesit të Testimit të Kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilistë të Miratuar” respektivisht Neni 11; si dhe Rregullores Nr. 9, datë 27.02.2019 “Për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Funksionimit të Organizatave Profesionale dhe Profesionit të Kontabilistit të Miratuar” e ndryshuar.

**Neni 1**

**Objekti dhe Qëllimi**

3. Kjo rregullore ka për qëllim:
  - 3.01. Organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Regjistrimit;
  - 3.02. Përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të çregjistrimit nga Regjistri Publik i Kontabilistëve të Miratuar;



- 3.03. Përcaktimin e procedurave për pasqyrimin e ndryshimeve në Regjistrin Publik të Kontabilistëve të Miratuar;
  - 3.04. Zbatimin e dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore për Licencimin e Anëtarëve të IKM Aktivë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë të pavarur dhe të regjistruar në QKB si persona fizik ose shoqëri kontabiliteti, të punësuar në shoqëri me kapital privat ose shtetëror si dhe organizma të tjerë privat ose shtetërore për të cilat nuk kanë pengesë ligjore;
  - 3.05. Zbatimin e dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore për pajisje me Kartën e anëtarësisë të Anëtarëve të IKM dhe me licencat profesionale;
  - 3.06. Zbatimin e dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore për vendosjen e rregullave dhe procedurave për procesin e lëshimit të kartave të anëtarësisë dhe Licencave, për formatin e tyre, mbajtjen e Regjistrit të Licencave dhe revokimin e tyre, pajisjen me Kartën e anëtarësisë të anëtarëve të IKM.
4. Kjo rregullore gjithashtu parashikon parimet dhe dispozitat që rregullojnë:
    - 4.01. Ripërtëritjen e Licencës;
    - 4.02. Ripërtëritjen e kartës së anëtarësisë;
    - 4.03. Tarifat e lëshimit të Licencës.

## **Neni 2**

### **Shkurtime dhe Përkufizime**

5. **KM** - Kontabilist i Miratuar
6. **Shërbimet e kontabilitetit** - janë shërbimet e mbajtjes dhe përgatitjes së librave kontabël, fiskalë dhe të pagave, të kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit kontabël, vlerësimet dhe analizat e kostos dhe kontabilitetit të drejtimit, vlerësimit dhe zbatimit të procedurave kontabël të përgatitjes së pasqyrave financiare, analiza financiare dhe këshillime përkatëse, si dhe shërbime të tjera të ngjashme të lidhura me raportimin financiar, kontrollin e brendshëm, performancën financiare, vlerësimet e biznesit, raportimin tatimor e doganor, dhe të tjera shërbime të renda dakord me klientët .
7. **KMA** – Kontabilist i Miratuar Aktiv, i cili është personi fizik, profesionist i lirë, i regjistruar në regjistrin e njëres prej organizatave profesionale të kontabilistëve të



miratuar, që kontraktohet nga personi juridik, për të kryer shërbime të kontabilitetit me kontrate shërbimi apo punësimi. Ai mund të kryejë edhe shërbime të tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

8. **KMJ** – Kontabilist i Miratuar Jo-aktiv (jo ushtrues i profesionit), është person, i regjistruar në regjistrin e njëjës prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, i pezulluar me kërkesën e tij nga organizata përkatëse për kryerjen e shërbimeve të kontabilitetit. Gjithashtu KMJ janë të gjithë ata individë që kanë fituar titullin KM dhe nuk ushtrjnë profesionin si person fizik i regjistruar ne QKB apo nuk janë të kontraktuar për të kryer shërbime kontabiliteti ose janë te punësuar ne institucione shtetërore apo publike qe nuk u lejohe te kryejnë shërbime kontabiliteti ose qe ne funksionet e tyre ne këto institucione nuk kryejnë shërbime kontabiliteti apo te lidhura me to..
9. **PPAP** – Provimi Përfundimtar i Aftësive Profesionale
10. **Person fizik** - është subjekti sipas kuptimit të Kodit Civil dhe ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, i cili ushtron një profesion të pavarur (Kontabilist të Miratuar).
11. **Shoqëri kontabiliteti** – Është një person juridik, pavarësisht formës së organizimit, i regjistruar në regjistrin publik të kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit, i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer shërbime kontabiliteti dhe që plotëson kriteret e parashikuar në legjislacionin në fuqi për shoqëritë e kontabilitetit.

### **Neni 3**

#### **Komiteti i Regjistrimit**

12. Komiteti i Regjistrimit, në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 10091, date 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar“ i ndryshuar dhe Rregullores Nr. 9 datë 27.02.2019 të BMP, është autoriteti i cili miraton regjistrimin dhe çregjistrimin e Kontabilistëve të Miratuar, shoqërive të kontabilitetit në Regjistrin Themeltar dhe Regjistrin Publik të anëtarëve te IKM si dhe regjistrimin dhe çregjistrimin e kandidatëve të cilët do t’i nënshtrohen testimit për marrjen e titullit “Kontabilist i Miratuar”.
13. Komiteti i Regjistrimit dhe Kryetari i Këshillit të Drejtimit ngarkohen me zbatimin e rregullave dhe të procedurave të vendosura në këtë Rregullore.



**Neni 4**  
**Përbërja**

14. Komiteti i Regjistrimit është një strukturë në varësi të Këshillit të Drejtimit. Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit zgjidhen nga Këshilli i Drejtimit.
15. Komiteti përbëhet nga 3 anëtarë, si me poshtë:
  - 15.01. Dy anëtarë Kontabiliste të Miratuar pjesë e Regjistrimit Publik të IKM, me propozim nga Këshilli i Drejtimit;
  - 15.02. Një anëtar i cili nuk është Kontabilist i Miratuar dhe vjen nga fusha e jurisprudencës, me propozim nga Këshilli i Drejtimit
16. Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit zgjidhen për një periudhë 4 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
17. Në rast të mbarimit të mandatit, anëtarët e Komitetit të Regjistrimit do qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj duke mos u kufizuar në ushtrimin e funksioneve të tyre deri në datën e zëvendësimit nga anëtarët e rinj.
18. Një anëtar i Komitetit të Regjistrimit mund të lirohet nga detyra në rastet kur:
  - 18.01. Mbaron mandati;
  - 18.02. Anëtari nuk paraqitet pa arsye në mbledhje 2 herë radhazi apo më shumë se 5 mbledhje përgjatë vitit;
  - 18.03. Çregjistrohet nga Regjistri Publik, ose ka pezulluar përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë si Kontabilist i Miratuar;
  - 18.04. Kur veprimet apo mosveprimet e tyre kanë dëmtuar emrin e Komitetit të Regjistrimit, ose IKM-së;
  - 18.05. Kryen veprime të paligjshme apo që cenojnë rëndë imazhin e Komitetit të Regjistrimit dhe IKM-së;
  - 18.06. Nuk përmbush funksionet e parashikuara nga kjo Rregullore;
  - 18.07. Me vendim nga Komisioni i Investigimit;
  - 18.08. Me propozim nga Këshilli i Drejtimit;



- 18.09. Ka konflikt interesi me funksionin e vet;
- 18.10. Jep dorëheqjen apo vdes;
- 19. Në rastin e lirimit nga detyra të anëtarit të Komitetit të Regjistrimit, sipas përcaktimeve të pikës 18, Këshilli i Drejtimit të IKM duhet të emërojë zëvendësuesin e tij brenda një afati prej 30 ditësh pune, duke filluar nga data e marrjes së propozimit/aplikimit përkatës në përputhje me procedurat e përzgjedhjes të parashikuara në këtë nen.
- 20. Mandati i zëvendësuesit llogaritet për pjesën e mbetur nga dita e emërimit të tij.

### **Neni 5**

#### **Procedurat e Punës të Komitetit të Regjistrimit**

- 21. Komiteti i Regjistrimit mblidhet të paktën 1 (një) herë në muaj brenda datës 5 të muajit nëse ka kërkesa të reja për regjistrim. Në organizimin e punës Komiteti i Regjistrimit mbështetet nga Struktura ekzekutive, të cilët edhe mund të marrin pjesë në mbledhje, kur kjo kërkohet nga anëtarët e Komitetit.
- 22. Komiteti i Regjistrimit është përgjegjës për shqyrtimin dokumentacionin e depozituar nga KM, shoqëritë KM dhe kandidatet për KM dhe merr vendimin për pranimin ose jo të kërkesës së paraqitur, njëkohësisht njofton personin e interesuar për vendimin e marrë nëpërmjet sekretarisë së IKM brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.
- 23. Për rastet kur KM, shoqëria KM ose kandidati për KM ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar për regjistrim, Komiteti i Regjistrimit e njofton personin dhe i le një afat prej 10 ditësh për plotësimin e tyre.
- 24. Komitetit i Regjistrimit miraton dhe urdhëron kryerjen e të gjitha ndryshimeve të tjera në regjistrin Themeltar të IKM të cilat lidhen me:
  - 24.01. Kalimin nga seksioni persona fizik apo shoqëri KM aktive në jo aktive dhe anasjellas;
  - 24.02. Kalimin nga seksioni i kandidateve në atë të anëtarëve aktiv ose jo aktiv pas certifikimit të tyre si KM;



- 24.03. Kalimin e personave fizik në shoqëri të kontabilistëve të miratuar dhe anasjellës;
25. Komiteti i Regjistrimit, brenda datës 10 të muajit kur zhvillohet mbledhja, i dorëzon Drejtorit Ekzekutiv listën me regjistrimet e reja dhe urdhrin për ndryshimet që duhet të bëhen në Regjistrin Themeltar.
26. E drejta e anëtarësimit pas miratimit nga Komiteti i Regjistrimit, fillon nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim.
27. Mbledhjet e Komitetit të Regjistrimit dokumentohen me procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari dhe të gjithë anëtarët pjesëmarrës.
28. Komiteti i Regjistrimit, mbështetur në këtë Rregullore është autoriteti që miraton regjistrimin e Kontabilistëve të Miratuar në Regjistrin Themeltar dhe Regjistrin Publik të IKM të anëtarëve Kontabilistë të Miratuar, si dhe është autoriteti i cili përgatit listën e anëtarësimeve të reja të Kontabilistëve të Miratuar. Ai gjithashtu është autoriteti për përcaktimin e listës së anëtarëve të IKM të cilët duhet të Licencohen dhe ia paraqet Kryetarit të Këshillit të Drejtimit për miratim nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv.
29. Kryetari i Këshillit të Drejtimit të IKM, pasi merr listën e anëtarëve për t'u pajisur me Licencë, vendos ta miratojë ose refuzojë atë në varësi të dokumentacionit të shqyrtuar.

## **Neni 6**

### **Regjistrimi i KM**

30. Ne regjistrin Themeltar dhe Regjistrin Publik të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar janë të regjistruar të gjithë ata persona të cilët plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 9 të nenit 2 të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar“ i ndryshuar dhe Rregullores Nr. 9 datë 27.02.2019 të BMP.
31. Për të bërë të mundur regjistrimin dhe publikimin e emrit në Regjistrin Themeltar dhe Regjistrin Publik të IKM, çdo Kontabilist i Miratuar fillimisht duhet të anëtarësohet pranë Institutit dhe duhet të plotësojë disa dokumente që shoqërojnë këtë anëtarësim.
32. Kërkesa për t'u anëtarësuar në IKM paraqitet nga të gjithë profesionistët që posedojnë Dëshminë “Kontabël i Miratuar”, të lëshuar nga një organ i caktuar me



ligj, nga IKM, ose nga organizma ekuivalente të njohur si dhe nga shoqëritë e kontabilitetit.

33. Dokumentet që duhen dorëzuar për anëtarësim në IKM janë si mëposhtme:

**33.01. Kontabilistet e Miratuar persona fizikë, profesionistë të lirë të regjistruar në QKB:**

- 33.01.A. Kërkesë me shkrim për anëtarësimin në shoqatë;
- 33.01.B. Curriculum Vitae (CV) në gjuhën shqipe;
- 33.01.C. Kopje e Dëshmisë Profesionale si Kontabël i Miratuar (e noterizuar) ose kopje të noterizuar të vërtetimit të provimeve ose të dokumentit përkatës të parashikuar dhe të lëshuar nga ana e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale;
- 33.01.D. Kopje e NUIS, nëse e ushtron profesionin i regjistruar në QKB;
- 33.01.E. Listën e Kontabilisteve të Miratuar te punësuar, nëse ka të punësuar;
- 33.01.F. Deklaratën personale të dy ose shumë punësimit (shoqëruar me vërtetimin përkatës nga sigurimet shoqërore);
- 33.01.G. Vërtetim nga organet e drejtësisë që nuk ka qenë i dënuar për vepra të cilat janë të lidhura me aktivitetin në fushën e profesionit (Dëshmi e gjendjes gjyqësore e tre muajve të fundit);
- 33.01.H. Kopje e Diplomës së Nivelit të Dytë ose ekuivalente e saj (DIND);
- 33.01.I. Kopje e dokumentit të identifikimit, pasaportë ose letër njoftimi;
- 33.01.J. Dy fotografi (formati 4x5 cm).

**33.02. Shoqëritë e Kontabilitetit**

- 33.01.A. Kërkesë me shkrim për anëtarësimin në shoqatë e cila mund të bëhet nga administratori i Shoqërisë ose nga ortaku Kontabilist i Miratuar;



- 33.01.B. Kopje të NIPT-it (NUIS);
  - 33.01.C. Kopje e ekstraktit historik;
  - 33.01.D. Statutin dhe Aktin e themelimit;
  - 33.01.E. Kopje e Dëshmisë Profesionale si Kontabilist i Miratuar të ortakut/ortakëve ose e administratorit;
  - 33.01.F. Vërtetim nga organet e drejtësisë që nuk ka qenë i dënuar për vepra të cilat janë të lidhura me aktivitetin në fushën e profesionit për ortakun/ortaket, për administratorin (në rast se është i ndryshëm nga Ortaku) dhe për Personin Juridik (Dëshmi e gjendjes gjyqësore e tre muajve të fundit);
  - 33.01.G. Kopje e Diplomës së Nivelit të Dytë ose ekuivalente e saj (DIND) e ortakut/ortakeve dhe e administratorit (në rast se është i ndryshëm nga Ortaku);
  - 33.01.H. Kopje e dokumentit të identifikimit, pasaportë ose letër njoftimi e ortakut/ortakeve ose e administratorit;
  - 33.01.I. Listën e Kontabilistëve të Miratuar të shoqërisë;
  - 33.01.J. Rregulloren e Parandalimit të Pastrimit të Parave nëse ka 3 (tre) ose më shumë të punësuar.
- 33.03. **Kandidatet** që aplikojnë për t'u pajisur me dëshminë "Kontabël i Miratuar", duhet të plotësojnë kërkesat e parashikuara në pikat "a", "b" dhe "ç", të nenit 16 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.09, "Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesve Ligjorë dhe të Kontabilistit të Miratuar" i ndryshuar si vijon:
- 33.01.A. Kërkesë me shkrim për anëtarësim drejtuar Komitetit të Regjistrimit e cila plotësohet sipas një formati të parashtypur e të miratuar nga Këshilli i Drejtimit i IKM;
  - 33.01.B. Kopje e dokumentit të identifikimit, pasaportë ose letër njoftimi;
  - 33.01.C. Kopje të diplomës së Nivelit të Dytë ose ekuivalente e saj (DIND);





- 33.01.D. Vërtetim nga organet e drejtësisë që nuk ka qenë i dënuar për vepra të cilat janë të lidhura me aktivitetin në fushën e profesionit;
  - 33.01.E. Një CV personale në shqip;
  - 33.01.F. 2 fotografi të madhësisë 4x5;
  - 33.01.G. Pagesa e kuotës fikse vjetore të anëtarësimit.
34. Në kërkesë përveç të tjerave deklarohet "njohja e Statutit të IKM dhe angazhimi për zbatimin e tij".

#### **Neni 7**

#### **Depozitimi i dokumentacionit të regjistrimit**

- 35. Kërkesat për anëtarësim si rregull paraqiten pranë Sekretarisë së IKM ose nëpërmjet aplikimit online, i cili administrohet nga Sekretaria e IKM. Në këtë rast Sekretaria mbasi kryen veprimet e regjistrimit, mbështetur dhe në vendimin e Komitetit të Regjistrimit i dërgon Kryetari të Degës ose Seksionit përkatës, të gjitha regjistrimet e reja.
- 36. Nëse kërkesa për regjistrim paraqitet pranë Degës ose Seksionet, këto të fundit çdo muaj kërkesat e paraqitura se bashku me dokumentacionin lidhur ia paraqesin sekretarisë së IKM, duke mbajtur kopjen e kërkesës për efekte evidentimi.
- 37. Sekretaria të gjitha kërkesat për regjistrim ja paraqet Komitetit të Regjistrimit jo më vonë se 10 ditë nga marrja e dokumentacionit të depozituar, i cili përgatit listën e regjistrimeve, çregjistrimeve, licensimit me dokumentacionin shoqërues për t'u shqyrtuar në mbledhjen e radhës ku merr vendimin përkatës për pranimin ose jo të kërkesës për anëtarësim.
- 38. Sekretaria pasi merr vendimin e Komitetit të Regjistrimit kryen veprimet e regjistrimit dhe njofton me shkrim Degën ose Seksionin për numrat e regjistrimit të anëtarëve të rinj. Bazuar në vendimin e Komitetit të Regjistrimit bëhet dhe përfshirja e emrit të anëtarit në regjistrin publik të anëtarësisë.



**Neni 8**  
**Anëtarësia**

39. Ne përputhje me kërkesat e pikës 2 te nenit 51 te ligjit Nr. 10091, date 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe te Kontabilistit te Miratuar“ i ndryshuar dhe Rregullores Nr. 9 date 27.02.2019 te BMP, IKM përgatit regjistrin e Themeltar të anëtarëve të tij të cilët janë KM, shoqëri kontabiliteti ose kandidatë për KM. Regjistri mbahet në formë elektronike dhe dokumentare. Ai është i ndarë në pesë seksione sipas kategorive të anëtarësimit dhe përkatësisht:
- 39.01. Anëtarë KM Aktive të vetëpunësuar;
  - 39.02. Shoqëri Kontabiliteti;
  - 39.03. Anëtarë KM Aktive të punësuar;
  - 39.04. Anëtarë KM Jo-Aktiv;
  - 39.05. Kandidatë për KM.
40. Ne përputhje me ndarjet e bëra në ligje, IKM ka përcaktuar edhe se cilët anëtarë do të përfshihen në këto ndarje (seksione).
- 40.01. **Anëtarë KM Aktive të vetëpunësuar** përfshin ata anëtarë te cilët:
- 40.01.A. Kanë certifikatë si Kontabël i Miratuar ose kanë vërtetimin e dhënies së provimeve për KM sipas ligjit;
  - 40.01.B. Ushetrojnë aktivitet si të pavarur dhe janë regjistruar ne QKB dhe në organet tatimore si Tregtarë të Regjistruar;
- 40.02. **Shoqëri Kontabiliteti** janë të gjitha ato shoqëri të cilat janë regjistruar në organet tatimore dhe qe janë krijuar sipas kërkesave të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“ dhe në zbatim të Rregullores Nr. 9 të BMP plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- 40.02.A. Është themeluar në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";



- 40.02.B. Shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri kontabiliteti ose nga kontabilistë të miratuar;
  - 40.02.C. Të paktën 50 për qind e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë së kontabiliteti janë KM të njohur nga Komiteti i Regjistrimit të IKM dhe të regjistruar në regjistrin publik të kontabilistëve të miratuar. Kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;
  - 40.02.D. Shoqëria angazhon kontabilistë të miratuar të cilët janë të regjistruar në regjistrin publik të kontabilistëve të miratuar.
  - 40.02.E. Shoqëria gëzon reputacion të mirë;
- 40.03. **Anëtarë KM Aktive të punësuar** përfshin ata anëtarë të cilët:
- 40.03.A. Zotërojnë Dëshminë Profesionale ose certifikatë si Kontabël i Miratuar ose kanë vërtetimin e dhënies së provimeve për KM sipas ligjit;
  - 40.03.B. Janë punësuar si Kontabël i Miratuar me kontratë individuale pune me kohë të plote ose të pjesshme dhe kryejnë shërbime të kontabilitetit dhe të lidhura me to dhe shërbime të tjera të lejuara nga ligji , dhe kur punësimi nuk përben konflikt me kërkesat ligjore të ushtrimit të profesionit si KM .
- 40.04. **Anëtarë KM Jo-Aktiv** përfshin ata anëtarë të cilët:
- 40.04.A. Zotërojnë Dëshminë Profesionale ose certifikatë si Kontabël i Miratuar;
  - 40.04.B. Nuk ushtrojnë aktivitet dhe nuk janë të regjistruar në QKB dhe as në organet tatimore;
  - 40.04.C. Janë të punësuar në sektorin publik ku nuk lejohet dypunësimi ose ku ushtrimi i profesionit të KM përben konflikt ligjor;
  - 40.04.D. Janë të punësuar me kontratë punësimi por që në njësinë ku punojnë kryejnë funksione që nuk lidhen me shërbimet që kryen si Kontabilist i Miratuar.



40.04.E. Janë ekonomikisht jo aktivë, nuk janë as të punësuar dhe as të vetëpunësuar.

40.05. **Anëtarë Kandidatë për KM** janë të gjithë ata persona të cilët plotësojnë kërkesat e germave "a", "b" dhe "ç" pikës 1 të nenit 16 të ligjit nr. 10091 datë 05.03.09 "Për Auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" i ndryshuar dhe janë anëtarësuar në IKM.

### **Neni 9**

#### **Procesi i Licencimit**

41. Do të pajisen me Licencë sipas kategorive të përcaktuara në Nenin 11 të kësaj rregulloreje të gjithë ata individë të cilët:
- 41.01. Janë anëtarë të IKM, Kontabilistë të Miratuar;
  - 41.02. I përkasin një prej kategorive të cilat mund të pajisen me licencë;
  - 41.03. Kane shlyer detyrimet e anëtarësisë të përcaktuara në statutin e IKM rregullisht;
  - 41.04. Anëtarët të cilët janë pajisur me Dëshmi Profesionale përpara vitit 2019, duhet të kenë kaluar procesin e verifikimit të përputhshmërisë ligjore të Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
  - 41.05. Kane dorëzuar vetë-deklarimet në lidhje me aktivitetin dhe punësimin (shoqëruar me vërtetimin përkatës nga sigurimet shoqërore);
  - 41.06. Nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata (vërtetuar me Dëshminë e Penalitetit);
  - 41.07. Nuk ka pengesa ligjore për të ushtruar profesionin (Vetë deklarim për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit).
42. Komiteti i Regjistrimit, i cili në kuadër të funksioneve të veta miraton regjistrimin e anëtarëve të rinj dhe të Shoqërive të Kontabilitetit, do të mbajë dhe regjistrin e licencave profesionale.
43. Pasi kryen verifikimet e nevojshme për plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë nen,



Komiteti i Regjistrimit përgatit listën e miratuar të anëtarëve të IKM, të cilët do të pajisen me licencë profesionale.

44. Kjo listë do të shoqërohet dhe me vendimin përkatës ku do të jenë të pasqyruar të gjithë anëtarët si dhe numri i licencës.
45. Komiteti i Regjistrimit ja paraqet listën e miratuar Kryetarit të Këshillit të Drejtimit, i cili kryen verifikimin dhe miratimin përfundimtar të anëtarëve të cilët do të licencohen.

### **Neni 10**

#### **Pajisja me Kartën e Anëtarësisë**

46. Do të pajisen me Kartë anëtarësie sipas kategorive të përcaktuara në Nenin 8 të kësaj rregulloreje të gjithë ata individë të cilët:
  - 46.01. Janë anëtarë të IKM dhe zotërojnë titullin Kontabilist i Miratuar;
  - 46.02. Kanë shlyer detyrimet e anëtarësisë të përcaktuara në statutin e IKM rregullisht;
  - 46.03. Kanë dorëzuar vetë-deklarimet në lidhje me aktivitetin dhe punësimin.
  - 46.04. Janë vlerësuar pozitivisht nga Komiteti i Regjistrimit për plotësimin e kushteve të kërkuara për licencim.
47. Komiteti i Regjistrimit pasi kryen verifikimet e nevojshme për plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë nen, përgatit listën e miratuar të anëtarëve të IKM, të cilët do të pajisen me kartën e anëtarësisë.
48. Kjo listë do të shoqërohet dhe me vendimin përkatës ku do të jenë të pasqyruar të gjithë anëtarët si dhe numri i kartës për secilin.
49. Komiteti i Regjistrimit ja paraqet listën e miratuar Kryetarit të Këshillit të Drejtimit, i cili kryen verifikimin dhe miratimin përfundimtar të anëtarëve.



**Neni 11**  
**Kategoritë e Licencave**

50. Ne përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10 091, date 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar; Rregullores Nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe Mbikëqyrjes së Procesit të Testimit të Kandidateve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar” respektivisht Neni 11; si dhe Rregullores Nr. 9, datë 27.02.2019 “Për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Funksionimit të Organizatave Profesionale dhe Profesionit të Kontabilistit të Miratuar” e ndryshuar; IKM do të lëshojë 2 (dy) lloje licencash si më poshtë:
- 50.01. Licencë Kategori A;
  - 50.02. Licencë Kategori AP.
51. Do të pajisen me Licencë të Kategorisë A të gjithë ata individë të cilët janë:
- 51.01. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të IKM, Persona Fizik (tregtare të regjistruar) Aktiv;
  - 51.02. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të IKM, Ortakë dhe Administrator të një Shoqërie Kontabiliteti.
52. Kontabilisti i Miratuar anëtar i IKM i pajisur me Licencë të Kategorisë A, në çdo rast do të lajmërojë IKM brenda 15 ditëve nëse ka ndryshim të statusit të tij të ushtrimit të aktivitetit si KM apo të punësimit si përcaktohet në piken 48.02 të kësaj Rregulloreje.
53. Nëse konstatohen shkelje ose mos deklaram i këtij ndryshimi në afatet e përcaktuara, ngarkohet Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës për shqyrtimin e rastit dhe marrjen e masave sipas Statutit dhe Rregulloreve në fuqi.
54. Do të pajisen me Licencë të Kategorisë AP të gjithë ata individë të cilët janë:
- 54.01. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të IKM, të punësuar në subjekte të tjera Person Fizik apo Juridik, OJF, apo edhe në Institucione ose Ndërmarrje shtetërore kur ky punësim lejon ushtrimin e aktivitetit si KM;



- 54.02. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të IKM, Ortak në një Shoqëri Kontabiliteti dhe nuk figurojnë si të punësuar në Listë pagesën e këtij subjekti, por e ushtrojnë profesionin me kontrate punësimi ne subjekte te tjera;
- 54.03. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të IKM, të punësuar si Administratorë pranë një Shoqërie Kontabiliteti;
- 54.04. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të IKM, të punësuar pranë një Shoqërie Kontabiliteti.
55. Për këtë kategori në çdo rast Kontabilisti i Miratuar anëtar i IKM duhet të lajmërojë organizatën për statusin e tyre të punësimit.
56. Nuk do të pajisen me Licencë të gjithë ata individë të cilët janë:
- 56.01. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të IKM, jo të vetëpunësuar ose jo të punësuar;
- 56.02. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të IKM, ortakë të një Shoqërie Kontabiliteti, jo të punësuar.
57. Vetëm Kontabilistët e Miratuar, anëtarë të IKM të cilët do te pajisen me Licencë të kategorisë A do të kenë të drejtën për t'u ofruar shërbime kontabiliteti sipas përcaktimeve ligjore palëve të treta me kontratë shërbimi.

## **Neni 12**

### **Formati i Licencës**

58. Licenca do të lëshohet sipas Formatit të miratuar nga Këshilli i Drejtimit.
59. Në të duhet të jenë të pasqyruara te dhënat e mëposhtme për të qenë e vlefshme:
- 59.01. Numri i Licencës, i përcaktuar sipas vendimit të Komitetit të Regjistrimit;
- 59.02. Emri, Atësia dhe Mbiemri i anëtarit për të cilin lëshohet licenca;
- 59.03. Objekti i Licencës (Titulli Kontabilist i Miratuar);
- 59.04. Kushtet e vlefshmërisë se Licencës;
- 59.05. Data e lëshimit;



- 59.06. Nënshkrimi i Kryetarit të Këshillit të Drejtimit të IKM;
  - 59.07. Afati i vlefshmërisë;
  - 59.08. Logo e IKM dhe Logo e IFAC sipas formatit të miratuar;
  - 59.09. Elementet e Sigurisë.
60. Licenca për të qenë e vlefshme duhet të ketë minimalisht 3 (tre) elemente sigurie, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Drejtimit.

### **Neni 13**

#### **Formati i kartës së anëtarësisë**

- 61. Karta e Anëtarësisë do të lëshohet sipas Formatit të miratuar nga Këshilli i Drejtimit.
- 62. Në të duhet të jenë të pasqyruara të dhënat e mëposhtme për të qenë e vlefshme:
  - 62.01. Logo e IKM dhe Logo e IFAC;
  - 62.02. Foto e mbajtësit të kartës së anëtarësisë;
  - 62.03. Emër, Atësi, Mbiemër;
  - 62.04. Numri i anëtarësisë;
  - 62.05. Numri i Kartës;
  - 62.06. Afati i vlefshmërisë se Kartës;
  - 62.07. Kodi serial (Numri i anëtarësisë/Viti i lëshimit);
  - 62.08. QR Code;

### **Neni 14**

#### **Regjistri Themeltar**

- 63. Regjistri Themeltar në seksionin e **Anëtarë KM Aktiv të vetëpunësuar** përmban disa informacione të organizuara në kolona të veçanta si vijon:
  - 63.01. Numrin e identifikimit personal (Nr. regjistrin);





- 63.02. Emër, Atësi, Mbiemër;
  - 63.03. Numrin e Dëshmisë së KM ose të vërtetimit të provimeve për KM;
  - 63.04. Viti i lëshimit të Dëshmisë Profesionale;
  - 63.05. Data e regjistrimit pranë IKM;
  - 63.06. Numri i Licencës;
  - 63.07. NUIS;
  - 63.08. Adresa e aktivitetit;
  - 63.09. Të dhënat personale (Nr. Personal i Mjetit të Identifikimit, datëlindja);
  - 63.10. Kontaktet;
  - 63.11. Statusi;
  - 63.12. Shënime të ndryshme që kanë të bëjnë me masat disiplinore të marra ndaj KM për shkeljet e konstatuara gjatë aktivitetit të tij.
64. I bashkëngjitet kësaj rregulloreje Formati i Regjistrimit për Anëtarët KM Aktiv të vetëpunësuar
65. Regjistri Themeltar në seksionin e **Shoqëri Kontabiliteti** do të përmbajë disa informacione të organizuara në kolona të veçanta si vijon:
- 65.01. Numrin e identifikimit personal (Nr. regjistrimit);
  - 65.02. Emri Tregtar;
  - 65.03. Ortakët;
  - 65.04. Administratori;
  - 65.05. Numrin e Dëshmisë të KM ose të vërtetimit të provimeve për KM të ortakut/eve dhe Administratorit ;
  - 65.06. Viti i Lëshimit të Dëshmisë Profesionale të ortakut/eve dhe Administratorit;
  - 65.07. Data e Regjistrimit pranë IKM;



- 65.08. Numri i Licencës;
  - 65.09. NUIS;
  - 65.10. Adresa e aktivitetit;
  - 65.11. Lista e KM të punësuar;
  - 65.12. Kontaktet;
  - 65.13. Statusi;
  - 65.14. Shënime të ndryshme që kanë të bëjnë me masat disiplinore të marra ndaj KM për shkeljet e konstatuara gjatë aktivitetit te tij.
66. I bashkëngjitet kësaj rregulloreje Formati i Regjistrimit për Shoqëritë e Kontabilitetit.
67. Regjistri Themeltar në seksionin e **Anëtarë KM Aktiv të punësuar** do të përmbajë disa informacione të organizuara në kolona të veçanta si vijon:
- 67.01. Numrin e identifikimit personal (Nr. regjistrimit);
  - 67.02. Emër, Atësi, Mbiemër;
  - 67.03. Numrin e Dëshmisë së KM ose të vërtetimit të provimeve për KM;
  - 67.04. Viti i Lëshimit të Dëshmisë Profesionale;
  - 67.05. Data e Regjistrimit pranë IKM;
  - 67.06. Numri i Licencës;
  - 67.07. Të dhënat personale (Nr. Personal i Mjetit të Identifikimit, datëlindja);
  - 67.08. Kontaktet;
  - 67.09. Statusi;
  - 67.10. Shënime të ndryshme që kanë të bëjnë me masat disiplinore të marra ndaj KM për shkeljet e konstatuara gjatë aktivitetit të tij.
68. I bashkëngjitet kësaj rregulloreje Formati i Regjistrimit për Anëtarët KM Aktiv të punësuar.



69. Regjistri Themeltar në seksionin e **Anëtarë KM Jo-Aktiv** do të përmbajë disa informacione të organizuara në kolona të veçanta si vijon:
- 69.01. Numrin e identifikimit personal (Nr. regjistrin);
  - 69.02. Emër, Atësi, Mbiemër;
  - 69.03. Numrin e Dëshmisë të KM ose të vërtetimit të provimeve për KM;
  - 69.04. Viti i Lëshimit të Dëshmisë Profesionale;
  - 69.05. Data e Regjistrimit pranë IKM;
  - 69.06. Adresa;
  - 69.07. Të dhënat personale (Nr. Personal i Mjetit të Identifikimit, datëlindja);
  - 69.08. Kontaktet;
  - 69.09. Statusi;
  - 69.10. Shënime të ndryshme që kanë të bëjnë me masat disiplinore të marra ndaj KM për shkeljet e konstatuara gjatë aktivitetit të tij.
70. I bashkëngjitet kësaj rregulloreje Formati i Regjistrin për Anëtarët KM Jo-Aktiv
71. Regjistri Themeltar në seksionin e **Kandidat për KM** do të përmbajë disa informacione të organizuara në kolona të veçanta si vijon:
- 71.01. Numrin e regjistrin;
  - 71.02. Emër, Atësi, Mbiemër;
  - 71.03. Datën e kërkesës për regjistrim;
  - 71.04. Adresën;
  - 71.05. Kontaktet;
  - 71.06. Të dhëna në lidhje me Certifikimin në SKK dhe SNRF;
  - 71.07. Statusi;



- 71.08. Shënime.
72. I bashkëngjitet kësaj rregulloreje Formati i Regjistrimit për Anëtarët KM Jo-Aktiv.
73. Numri i regjistrimit të anëtarit të IKM është i pandryshueshëm. Në rast çregjistrimi për shkak përjashtimi ose largimi vullnetar, ai nuk i jepet në përdorim ndonjë personi tjetër. Në kolonën "shënime" bëhet shënimi i datës së largimit dhe çregjistrimit nga regjistri i IKM.
74. Këshilli i Drejtimit informohet në çdo mbledhje të radhës së tij nga Komiteti i Regjistrimit në lidhje me situatën e anëtarësisë, regjistrimet dhe çregjistrimet në Regjistrin Themeltar.
75. Këshilli i Drejtimit miraton listën përfundimtare një here në çdo tre muaj të anëtarëve të IKM dhe ia dërgojnë atë për informacion institucioneve dhe organeve të interesuara (BMP, QKB, Tatime, Gjykata etj.).

### **Neni 15**

#### **Regjistri Publik**

76. Në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 51 të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" i ndryshuar dhe Rregullores Nr. 9 datë 27.02.2019 të BMP, Komiteti i Regjistrimit përgatit dhe miraton Regjistrin Publik të anëtarëve të tij të cilët janë KM Aktive, shoqëri kontabiliteti dhe KM Jo Aktive. Regjistri mbahet në formë elektronike dhe publikohet në faqen e webit të IKM.
77. Në Regjistrin Publik janë listuar ata anëtarë të IKM Kontabilistë të Miratuar, të cilët do të pajisen me Licencë sipas përcaktimeve të Nenit 9 dhe Nenit 18 të kësaj rregulloreje.
78. Në Regjistrin Publik do të jenë listuar dhe ata anëtarë të IKM Kontabilistë të Miratuar Jo Aktive, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në Nenin 9 dhe Nenin 18 të kësaj rregulloreje.
79. Regjistri Publik përditësohet në përfundim të procesit të Ripërtërimit të Licencave në bazë vjetore, në përfundim të procesit të licencimit për anëtarësimet e reja, si dhe në përputhje me vendimet e marra nga Komiteti i Regjistrimit për ndryshime në



Regjistrin Themeltar.

**Neni 16**  
**Regjistri i Licencave**

80. Regjistri i Licencave do të ketë formatin e mëposhtëm:
- 80.01. Numër Rendor;
  - 80.02. Emër;
  - 80.03. Atësi;
  - 80.04. Mbiemër;
  - 80.05. Dega ose Seksioni përkatës;
  - 80.06. Numër i licencës;
  - 80.07. Data e lëshimit;
  - 80.08. Afati i vlefshmërisë;
  - 80.09. Statusi (Aktiv, Jo-Aktiv, Revokuar);
  - 80.10. Shënimet Përkatëse.
81. Ngarkohet Komiteti i Regjistrimit nëpërmjet Strukturës Ekzekutive të mirëmbajë dhe të përditësojë Regjistrin e Licencave. Regjistri i licencave mbahet në mënyrë të pavarur dhe veçmas nga regjistri i anëtarësisë së IKM.

**Neni 17**  
**Afati i vlefshmërisë**

82. Pas datës së lëshimit, Licenca është e vlefshme për një afat 1(një) vjeçar.
83. Kartat e Anëtarësisë pas datës së lëshimit të tyre janë të vlefshme për një afat 5 (pesë) vjeçar.
84. Gjatë kësaj periudhe anëtari i licencuar duhet të ketë plotësuar te gjitha kërkesat e



anëtarësisë sipas përcaktimeve në statut.

85. Afati i vlefshmërisë së Licencës, mund të ndryshojë me vendim të Këshillit të Drejtimit.
86. Komiteti i Regjistrimit çdo vit do duhet të bëjë verifikimin e deklaratave të aktivitetit dhe punësimit të anëtarëve të IKM për të saktësuar nëse ata vijnë apo jo të plotësojnë kushtet për të mbajtur licencën ose nëse ka ndryshim në kategorinë e tyre. Për këtë qëllim Komiteti i Regjistrimit përgatit formularin e kërkesës që duhet të plotësojnë KM anëtarë të IKM për të vetë-deklaruar plotësimin e këtyre kushteve, si dhe të bashkëngjisin dokumentacionin përkatës.

### **Neni 18** **Ripërtëritja e Licencës**

87. Të gjitha Licencat do të ripërtërihen brenda 3 mujorit të parë të çdo viti, pasi të kryhen verifikimet përkatëse për plotësimin e kushteve, duke reflektuar dhe ndryshimet përkatëse nëse ka.
88. Për ripërtëritjen e Licencës, anëtari i IKM, Kontabilist i Miratuar duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e përcaktuara në pikën 38, Neni 9 të kësaj rregulloreje.
89. Komiteti i Regjistrimit pasi të verifikojë Deklaratat Vjetore, përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe rregulloret e IKM, si dhe Vendimet e marra nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës do të përgatisë listën e Kontabilistëve të Miratuar anëtarë të IKM të cilët do të pajisen me licencë për vitin përkatës.

### **Neni 19** **Revokimi i Licencës**

90. Të drejtën e Revokimit të Licencës e ka Këshilli i Drejtimit, i cili vepron nëpërmjet Komitetit të Regjistrimit.
91. Revokimi i licencës kryhet:
  - 91.01. Me kërkesë të vetë anëtarit;



- 91.02. Kur anëtari nuk plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin Nr. 10091/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Statutin e Shoqatës dhe rregulloret e saj;
  - 91.03. Kryen veprime në kundërshtim me Kodin e Etikës profesionale, Statutin ose dispozitat ligjore në fushën e profesionit;
  - 91.04. Si rrjedhojë e gjetjeve të konstatuara ose marrja e rezultatit “dobët” nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë;
  - 91.05. Si rrjedhojë e masave të marra nga shkeljet e konstatuara nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës;
  - 91.06. Ne rastet kur Kontabilistit të Miratuar i hiqet e drejta për të ushtruar profesionin me vendim të BMP-se;
  - 91.07. Në rast se anëtari humb jetën;
92. Vendimi i Revokimit i paraqitet Komitetit të Regjistrimit për të përditësuar Regjistrin e Licencave dhe Regjistrin e Publik të IKM.

### **Neni 20**

#### **Heqja e Anëtarësisë**

93. Heqja e anëtarësisë nga IKM bëhet:
- 93.01. Me kërkesë të anëtarit;
  - 93.02. Kur anëtari nuk plotëson kushtet e anëtarësisë të përcaktuara në Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.09, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar“ i ndryshuar, Statutin e Shoqatës dhe rregulloret e saj;
  - 93.03. Me revokimin e Licencës;
  - 93.04. Kryen veprime në kundërshtim me Kodin e etikës profesionale, Statutin ose dispozitat ligjore në fushën e profesionit;
  - 93.05. Si rrjedhojë e masave të marra për shkeljet e konstatuara nga Komiteti i



Investigimit dhe Disiplinës;

93.06. Ne rast se anëtari vdes;

93.07. Anëtari kandidat për KM humbet të drejtën për të aplikuar për marrjen e Dëshmisë Kontabël i Miratuar.

94. Me revokimin e anëtarësisë, Karta e Anëtarësisë bëhet e pavlefshme.

### **Neni 21**

#### **Çregjistrimi i Shoqërive të Kontabilitetit**

95. Shoqëria e kontabilitetit çregjistrohet nga Regjistri Publik i anëtarësisë:

95.01. Me kërkesën e saj të bërë nga administratori i shoqërisë;

95.02. Përfundon afatin e ushtrimit të veprimtarisë së parashikuar në statutin e vet;

95.03. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri kontabiliteti hiqet si rrjedhojë e masave disiplinore të marra nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës, shkeljeve të tjera ligjore në fushën e profesionit, ose si rezultat i heqjes së statusit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

### **Neni 22**

#### **Tarifat e aplikueshme**

96. Te gjithë anëtarët të cilët do të pajisen me Licencë, do të tariforen aq sa është dhe kosto e lëshimit të kësaj licence, e cila do të kërkohet së bashku me kuotën vjetore të anëtarësisimit.

97. Kostoja e lëshimit të Licencës do të miratohet me Vendim të Këshillit të Drejtimit dhe do të jetë e aplikueshme për Lëshimin e Licencës dhe për Ripërtëritjen e saj.

98. Te gjithë anëtarët të cilët do të pajisen me Kartë Anëtarësie, do të tariforen aq sa është dhe kosto e lëshimit të saj, e cila do të kërkohet së bashku me kuotën vjetore të anëtarësisimit në momentin e lëshimit.

99. Kostoja e lëshimit të Kartës së Anëtarësisë miratohet me Vendim të Këshillit të Drejtimit dhe është e aplikueshme për Lëshimin dhe për Ripërtëritjen e saj.





**Neni 23**

**Miratimi dhe Hyrja ne fuqi**

100. Drejtori Ekzekutiv dhe stafi që ka në varësi është përgjegjës për publikimin në faqen e internetit të IKM të Regjistrimit Publik të anëtarëve. Mbi bazën e të dhënave të mara nga Komiteti i Regjistrimit bën përditësimin të paktën një herë në muaj të regjistrimit themeltar dhe Regjistrimit Publik me ndryshimet në anëtarësi.
101. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli i Drejtimit të IKM.
102. Ngarkohet stafi Ekzekutiv i IKM, që të informojë gjithë anëtarësinë në lidhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
103. Rregullorja është rishikuar ne përputhje me kërkesat e Ligjit 10091 05.03.2009 i ndryshuar me ligjin 47/2016.

**15 Shtator 2016**

**Kryetari i Këshillit te Drejtimit**  
**Prof. Dr. Sotiraq DHAMO**